

## JETESHKRIMI I REMZI PERNASKES

Profesor doktor Remzi Përnaska është gjuhëtar i shquar shqiptar dhe mësues e pedagog i përkushtuar i arsimit shqiptar. Fusha ku ka punuar më shumë është sintaksa e gjuhës shqipe ku ka sjellë vështrime të reja me interes edhe për gjuhësinë e përgjithshme e atë teorike.

Ka lindur në Korçë më 20 dhjetor 1934. Shkollën fillore, shtatëvjeçare dhe të mesme i kreu në qytetin e lindjes, kurse studimet e para të larta për gjuhë dhe letërsi ruse në Institutin e Lartë Pedagogjik dyvjeçar të Tiranës më 1956.

Pas mbarimit të studimeve të larta për gjuhë ruse më 1956 ka punuar si mësues i gjuhës shqipe dhe ruse në Cërrik të Elbasanit deri në vitin 1960, kur u dërgua për të mësuar turqishten në Institutin e Gjuhëve të Lindjes në Moskë. Më 1961, vazhdoi studimet e larta në degën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të cilat i kreu më 1963.

Për rezultate të shkëlqyera në studimet e larta, e mbajtën pedagog të sintaksës së gjuhës shqipe në katedrën e gjuhës shqipe të këtij fakulteti, ku punoi prej vitit 1963 deri në vitin 1974.

Në vitin 1974 u dërgua si lektor i gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhëve dhe të Qytetërimeve Lindore në Paris, ku punoi deri në vitin 1982. Gjatë kësaj kohe ndoqi kurse të ndryshme për gjuhësi të përgjithshme dhe teorike. Ndoqi kurset e gjuhëtarit të madh francez Andre Martinet si edhe të gjuhëtarit tjetër të shquar francez Antoine Culioli, nën udhëheqjen shkencore të të cilit përgatiti një tezë për gradën më të lartë shkencore që ka Franca : "Doktor Shteti".

Nga tetori i vitit 1991 deri në shtator 1997 ka punuar sërish si lektor i gjuhës shqipe në Institutin e Gjuhëve dhe të Qytetërimeve të Lindjes në Paris, si edhe në Ecole Pratique des Hautes Etudes të Universitetit të Sorbonës si profesor.

Që nga viti 1975 është anëtar i *Qendrës së Studimeve Ballkanike të Parisit* dhe i *Shoqatës Ndërkombëtare të Gjuhësisë Funktionale*, kurse nga viti 1976 anëtar i *Shoqatës së Gjuhëtarëve të Parisit* dhe nga viti 1994 edhe i *Shoqatës së Gjuhëtarëve të Francës*, që nga themelimi edhe i *Rrethit të Gjuhëtarëve të Institutit Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore* (viti 1997).

Pas kthimit në atdhe më 1982, u emërua punonjës shkencor në Sektorin e Gramatikës dhe të Dialektologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ku punoi deri në vitin 1991.

Ka botuar mbi 50 artikuj shkencorë në revista shqiptare "Studime filologjike", "Studia albanica", "Studime", "Gjurmime albanologjike" etj. si edhe në revista të huaja të specializuara në gjuhësi, si "Cahiers balkaniques", "Faits de langue", "Travaux du cercle des linguistes de l'INALCO", "Presses Universitaires de France", etj.

Është autor i dy krerëve ( kundrina, rrethanori) të veprës madhore *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Është anëtar jurie për mbrojtje disertacionesh në Universitetin e Sorbonës, në Institutin e Gjuhëve dhe të Qytetërimeve Lindore në Paris, në universitetet e Puatjesë dhe të Monpëliesë.

Ka qenë anëtar i redaksisë së revistës "Studime filologjike".

Ka qenë anëtar i Këshillit shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nga viti 1983 deri në vitin 1991.

Ka qenë delegat në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe më 1972, ku ka diskutuar dhe mbajtur një kumtesë.

Ka mbajtur ligjërata për gjuhën shqipe në universitete të huaja si në Athinë, Paris, Këln, Puatje, Marsejë, Nantë, Mynik, etj.

Ka hartuar disa zëra për *Fjalorin enciklopedik shqiptar* .

Ka marrë pjesë në kongrese dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për gjuhësi, si ato të organizuara në Këln të Gjermanisë (1988), në Paris nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimeve e Francës, në janar 1994, nga shoqata gjuhëtarësh të gjuhësisë së përgjithshme në Francë, në tetor 1995, në qershor 1996, në qershor 1997, në tetor 1997, në shkurt 1999 etj. Ka marrë pjesë me kumtesa në tri Konferencat Ndërkombëtare të organizuara në Sankt-Peterburg, për nder të A. V. Desnickajas, si dhe nga Rrethi i Gjuhëtarëve të INALCO-s në qershor dhe në tetor 1996, në 1997 dhe në 1998, si edhe në shkurt 1999, në Marsejë, etj.

Profesor Përnaska ka mbrojtur tri disertacione, dy në Francë dhe një në Shqipëri.

Në vitin 1994 paraqiti një tezë nga sintaksa e gjuhës shqipe në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta të Sorbonës, mbrojtja me sukses e së cilës i dha diplomën e studimeve të larta në Sorbonë dhe emërtimin "Nxënës i vjetër i Sorbonës".

Ka mbrojtur një disertacion me temën "Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe" dhe ka fituar gradën "Doktor i shkencave" në Shqipëri. Ky disertacion është botuar si libër në Kosovë (Pejë).

Ka mbrojtur një disertacion me temën "Sintaksa e thënies në gjuhën e sotme shqipe (Sintaksa e trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë)" dhe ka fituar gradën më të lartë shkencore që ka Franca: "Docteur d'Etat és lettres et sciences humaines", si edhe të drejtën për të udhëhequr punime doktoratash në Shqipëri dhe në Francë, për të qenë anëtar jurish për mbrojtje doktoratash. Kjo doktoratë e mbrojtur në Departamentin e gjuhësisë teorike të Universitetit Paris VII, i dha titullin "Profesor" në Francë dhe u botua në frëngjisht nga Presses Universitaires du Septentrion, Lille 1997, 672 faqe.

Profesor Përnaska ka botuar katër libra në Francë. Ka hartuar një libër me titullin "Parlons albanais", që u botua më 1999 nga Shtëpia Botuese "L'Harmattan" dhe u ribotua deri më tani tri herë. Bashkautorë Ch. Gut dhe A. Gut.

Ka botuar gjithashtu dy doracakë *Glossaire et guide militaire de conversation français - albanais*, E.I.R.E.L, Alb. 02, Strasbourg, 1997, 222 f. dhe *Eléments de grammaire albanaise, Complément au Glossaire* Alb 02, E.I.R.E.L, Alb. 03, Strasbourg, 1997, 60 f.

Punon për hartimin e një fjalori shqip-frëngjisht të tipit të mesëm (mbi 60.000 fjalë) në Laboratorin FORELL të Universitetit të Puatjesë, si edhe për pjesën shqipe në një fjalor shprehjesh që po hartohet nga Qendra e Kërkimeve dhe e Studimeve për Përhapjen e Frëngjishtes të Ecole Normale Supérieure në Fontenay/Saint-Cloud.

Që nga viti shkollor 1997-1998 e deri sa doli në pension ka qenë "Professeur associé" në Ecole pratique des hautes Etudes të Universitetit të Sorbonës, ku ka drejtuar seminarin për tekstet e vjetra në gjuhën shqipe.

Është autor tekstesh shkollorë për arsimin e lartë dhe të mesëm, i dhjetëra artikujve shkencorë, botuar në revistat tona shkencore dhe në ato të huaja, i dhjetëra artikujve në shtypin e përditshëm shqiptar. Bibliografia e punimeve të tij është mjaft e pasur.

Ka marrë pjesë në tubime shkencore ndërkombëtare e komisione për informatizimin e të dhënave gjuhësore shqipe si në Ösnabruck të Gjermanisë dhe në European Commission, Directorate-General, Joint Research Centre në Itali, në Zagreb e Beograd.

Ai vazhdon të punojë. Është ftuar disa herë nga Universiteti « Aleksandër Xhuvani » i Elbasanit ku ka mbajtur ligjërata për gjuhësi teorike. Kohët e fundit i ka dhuruar Universitetit « Aleksandër Xhuvani » të Elbasanit bibliotekën e vet albanologjike dhe të gjuhësisë teorike, me rreth 2000 vëllime.

Ka përkthyer nga frëngjishtja këta tre libra : Luan Starova, *Faik Konitza et Guillaume Apollinaire - une amitié européenne*, L'Esprit des Péninsules, Paris, 1998, 239 f.; Christian Gut, *Pasco Vassa (1825 - 1892)*, Prishtinë, 2008, 760 f.; Gabriel-Xavier Culioli, *La terre des seigneurs, Un siècle de la vie d'une famille corse*, Lieu commun, Paris, 1986, 181 f.

Profesor Përnaska po punon prej shumë vitesh për ngritjen e një monumenti me kalë të Skënderbeut në sheshin me të njëjtin emër në Paris.

Është dekoruar me urdhrin "Naim Frashëri" të klasit të dytë.

Mendoj se për të gjitha këto, si edhe për cilësitë njerëzore të tij ai e meriton tërësisht titullin

nderues *Doctor Honoris Causa* i Universitetit « Aleksandër Xhuvani » të Elbasanit.

Prof. Dr. Tomorr Plangarica  
Universiteti « Aleksandër Xhuvani » i Elbasanit  
Departamenti i gjuhës